



Duke u bazuar në Shkresën përcjellse të MAPL-ës nr. 0203/2012/2 të dt. 22.01.2015 si dhe Shkresës së Komisionit të përbashkët ndërmëntor të MF-ve dhe MAPL-ës të dt. 20.01.2015 që ka të bëjë me vlerësimin e ligjshmerisë së Rregullorës komunale për Tarifën, Ngarkesat dhe Gjohat komunale (teksti i spastruar), i miratuar më dt.26.12.2014, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e vetë të rregullt të I-ën më radhë për vitin 2015, të mbajtur më dt. 30.01.2015, **m i r a t o i**:

V E N D I M

Për

Përmirësimin e gabimeve teknike në Rregullorën për Tarifën, Ngarkesat dhe Gjohat komunale (Teksti i spastruar) e miratuar më dt.26.12.2014

I

Bëhet përmirësimi i gabimeve teknike në Rregullorën për Tarifën, Ngarkesat dhe Gjohat komunale (Teksti i spastruar) e miratuar më dt. 26.12.2014, ashtu që:

1. Në nenin 10 hiqet teksti i paragrafit të 5: „Për shfrytëzimin e panevojshëm dhe ilegal të ujit të pishëm që përdoret për qëllime të pastrimit, rrugëve, trotuareve, oborreve, për ujitje të kopshteve, fushave, pemëve etj. përcaktohet gjoba në lartësi prej 25 €,,.

Arsyeja e heqjes është se denimet e tilla nuk i cakton komuna por kompania publike që furnizon me ujë të pishëm Komunën e Klinës.

2. Neni 11 që ka të bëjë me denimet e tjera hiqet.

Arsyeja është sepse komuna nuk jep leje e asë licenca dhe asë nuk mund të ketë denime për to.

3. Në nenin 17 hiqet pika 17.4 që ka të bëjë me taksën për paraqitjen e ankesave. Arsyeja është se ankesa nuk bëhet më pagesë.

4. Neni 29 po ashtu hiqet. Ky nen kishte të bënte me regjistrimin e përvojave.

Arsyeja e heqjes së këtij neni është se kategoria e tillë është e përfshirë në Udhëzimin Administrativ nr. 08/2014 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

II

Teksti tjetër i Rregullorës komunale për Tarifën, Ngarkesat dhe Gjohat komunale i miratuar më dt. 26.12.2014 mbetet i pa ndryshuar dhe prodhon efekt të plotë juridik ngase sipas konstatimit të Komisionit të përbashkët që delë nga shkresa e cekur si në hyrje të këtij vendimi tani edhe i tërë tekstit i rregullorës konstatohet se është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

III

Ky Vendim është i plotëfuqishëm dhe hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

IV

Përmirësimin e gabimeve teknike, Inkorporimin e këtij Vendimi si dhe renditjen teknike të dispozitave juridike në tekstin e spastruar të Rregullores lëndore do ta bëjë Zyra e Përfaqësimit dhe Çështjeve ligjore së bashku me Shërbimin për Punë të Kuvendit të Komunës së Klinës dhe Drejtorinë e Financave.

V

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është Shkresa rekomanduese e vlerësimit të ligjshmerisë e MF-ve dhe MAPL-ës e dt. 20.01.2015.

VI

Më Vendim të njoftohën: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës, Komisioni i përbashkët i MF-ve dhe MAPL-ës në Prishtinë, një kopje publikohet në tabelën e shpalljeve, një publikohet në web faqën zyrtare të Komunës, një kopje mbetet për Zyrën e Përfaqësimit dhe Çështjeve ligjore dhe Shërbimin për Punë të Kuvendit, si dhe një kopje Arkiva.

Nr. 01-06-594/2015
Klinë, më dt. 30.01.2015.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi